REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 18-58/17
Datë/Datum. 23.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 48/17
58/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 paragrafi 2, pika 2.16, nenit 106, nenit 131 lidhur me nenin 25 paragrafi 9 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 28 paragrafi 1 i Rregullores së Punës, në përbërje prej **Ekrem Salihu- Kryetar, Nuhi Paçarizi- Referues dhe Blerim Dina-Anëtar,** duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 48/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **"ER-LIS sh.p.k. &VE-MOR sh.p.k."** me seli në Pejë, dhe ankesës me nr. të protokollit 58/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **N.T.SH." KANALPROFIS"** me seli në Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave",** me nr. prokurimit: 6120/16/097/221, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Komuna e Fushë Kosovës, në seancën e mbajtur me dt. 17 mars 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik **"ER-LIS sh.p.k. &VE-MOR sh.p.k."** me seli në Pejë, me nr. të protokollit 48/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave",** me nr. prokurimit: 6120/16/097/221, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Komuna e Fushë Kosovës.

II. **Anulohet,** vendimi i autoritetit kontraktues-Komunës së Fushë Kosoves, njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave",** me nr. prokurimit: 6120/16/097/221, dhe lënda kthehet ne Rivlerësim .

III. **HEDHET ,** si e palejuar ankesa e OE **N.T.SH." KANALPROFIS"** me seli në Fushë Kosovë, me nr. të protokollit 58/17, kundër vendimit të autoritetit kontraktues njoftim për anulim aktivitetit të prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave",** me nr. prokurimit: 6120/16/097/221, për shkak se i njëjti nuk ka mund të dëshmoj interes juridik material konfrom nenit 111 par. 1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP-së pasi i njëjti është i papërgjegjshëm.

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

VI. Operatorit ekonomik ankues **"ER-LIS sh.p.k. &VE-MOR sh.p.k."** me seli në Pejë, dhe OE **N.T.SH." KANALPROFIS"** me seli në Fushë Kosovë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VII. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues–Komuna e Fushë Kosovës, më dt. 28 dhjetor 2016, ka publikuar *Njoftim për Kontratë,* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave",** me nr. prokurimit: 6120/16/097/221.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 2 (dy) operator ekonomik, ku sipas komisioni të vlerësimit të ofertave 2 (dy) operatoret ekonomik janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk i plotësoj kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues më dt. 16 shkurt 2017 ka publikuar njoftimi për anulimin e aktiviteit të prokurimit.

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim, operatori ekonomik **"ER-LIS sh.p.k. &VE-MOR sh.p.k."** me seli në Pejë dhe operatori ekonomik **N.T.SH." KANALPROFIS"** me seli në Fushë Kosovë, në afatin e paraparë ligjor kanë parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Operatori ekonomik ankues **"ER-LIS sh.p.k. &VE-MOR sh.p.k."** me seli në Pejë, pretendon se autoriteti kontraktues Komuna e Fushë Koovës, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje te nenit 7, nenit 59 dhe nenit 62 të LPP-së, si dhe neni 2-Përkufizimet-Ligji Nr. 05/L-37, pët tatimin mbi vlerën e shtuar.

Operatori ekonomik ankues **N.T.SH.“ KANALPROFIS”** me seli në Fushë Kosovë, pretendon se autoriteti kontraktues Komuna e Fushë Koovës, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje te nenit 1 paragrafi 1, paragrafi 2 dhe paragrafi 3 , nenit 6 pargrafi 1 dhe 2 dhe nenit 3 paragrafi 5 të LPP-së.

Ankesat e operatorve ekonomik janë të afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personave kompetent.

Ankesa **“ER-LIS sh.p.k. &VE-MOR sh.p.k.”** me seli në Pejë e është e bazuar, ndërsa ankesas e **N.T.SH.“ KANALPROFIS”** me seli në Fushë Kosovë, hudhet posht si e pa lejuar .

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 01 mars 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, me datën 06 mars 2017, i dorëzon, panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “ER-LIS&VE-MOR”sh.p.k, sa i përket arsyes të eliminimit në lidhje me normen e TVSH-së të ofruar për pozicionet e çmimit nr.13,14,15,16,18,19,20,21 dhe 22, sqaron se qëndron duke u bazuar në atë se Autoriteti kontraktues është i obliguar **korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-së, pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.**

Citim: interpretimi i KRPP-së të publikuar në pyetje dhe përgjigjje nr.46, citojmë: “si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 59 të LPP-së, vlerëson se qëndron pasi që autoriteti kontraktues gjate ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertvae nuk ka vepruar ne harmoni me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, duke eliminuar operatorin ekonomik ankues në fjalë edhe pse i njejti kishte ofertuar në harmoni me kriteret e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues N.T.SH.“ KANALPROFIS”, eksperti shqyrtues fillimisht s’qaron se operatori ekonomik ankues “Kanalprofis”, nuk ka arritur të përshkruaj saktë rrethanat faktike apo dispozitat që pretendon që përbëjnë ose që ngrisin supozimin për shkeljen e këtij ligji, në harmoni me nenin 111, paragrafi 1.6 dhe 1.8 të LPP-së, i njëjti duke u bazuar në nenin e lartë cekur paragrafi 1.5 lidhur me nenin 4 të LPP-së nuk dëshmon interes material-juridik pasi që në asnjë rrethan nuk mundet të jetë nënshkrues i kontratës për këtë aktivitetit të prokurimit, duke u bazuar në atë se operatori ekonomik ankues ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe i njëjti pranon në ankes dhe përgjigjje me shkrim drejtuar autoritetit kontraktues se ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta për pozicionet nr.3,6,7 dhe 8, që e bëjnë të papërgjegjshme oferten e këtij operatori ekonomik.

Bazuar në atë që u tha më lartë, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të bazuar, ankesën e OE ankues “ER-LIS&VE-MOR”sh.p.k, me seli në Pejë, ndërsa ankesen e OE ankues N.SH.T. “KANALPROFIS” me seli në Fushë Kosovë të HUDHET POSHTË si e palejuar, dhe njëherit aktivitetin e prokurimit ta kthejë në RI-VLERËSIM.

Operatori ekonomik ankues “ER-LIS&VE-MOR”sh.p.k, përmes parashtresës me shkrim të dt. 12 mars 2017, njofton panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 06 mars 2017.

Operatori ekonomik ankues N.SH.T. “KANALPROFIS” përmes parashtresës me shkrim të dt. 09 mars 2017, njofton panelin shqyrtues se të njëjtit nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe njëkohësisht kërkojnë mbajtjen me panelin shqyrtues.

Paneli shqyrtues me dt. 17 mars 2017, conform nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës, me konkluzion refuzon kërkesën e OE N.SH.T. “KANALPROFIS” për mbajtje të sencës së hapur.

Me rastin e shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve ankimore , para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit kërkesës për kualfikim, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktiviteit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik ankues “ER-LIS&VE-MOR”sh.p.k dhe ankesa e operatorit ekonomik ankues N.SH.T. “KANALPROFIS” , raporti i eksperti shqyrtues i dt. 06 mars 2017, si dhe parashtresat operatorëve ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues.

Eksperti shqyrtues gjatë seances dëgjimore deklaroj: të asyet mbi përgjegjshmërin-mos përgjegjshmërin e operatorve ekonomik ankues i gjeni të materlizuara ne raportin e ekspertizës të dt. 06 mars 2017.

Në fund të prezantimit eksperti shqyrtues deklaroj: “qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raport”.

Pretendimi i operatorit ekonomik "ER-LIS&VE-MOR"sh.p.k, ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, konstaton se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se arsyet e dhëna për eliminimin e operatorit ekonomik ankues në lidhje me normen e TVSH-së të ofruar për pozicionet e çmimit nr.13,14,15,16,18,19,20,21 dhe 22, nuk qëndrojnë pduke u bazuar për arsye se autoriteti kontraktues është i obliguar ti korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-së, pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga operatori ekonomik në fjalë.

Bazuar në atë qu tha me lartë paneli shqyrtues konsaton se autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka vepruar ne harmoni me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, duke eliminuar operatorin ekonomik ankues në fjalë edhe pse i njejti kishte ofertuar në harmoni me kriteret e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertit shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorëve ekonomik ankues, parashtresës së operatorit ekonomik ankues "ER-LIS&VE-MOR"sh.p.k, të dt. 12 mars 2017, parashtresës së operatorit ekonomik ankues N.SH.T. "KANALPROFIS", të dt. 09 mars 2017 , sqarimet e dhëna nga ekspertit shqyrtues , konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e rrjetit tè ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave",** me nr. prokurimit: 6120/16/097/221, nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart,ia fali besimin raportit të ekspertit shqyrtues të dt.06.03.2017 dhe konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Ekrem Salihu

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – OE "ER-LIS&VE-MOR"sh.p.k Pejë
1x1 ekzemplar- OE N.SH.T. "KANALPROFIS" Fushë Kosovë
1x1 ekzemplar - AK Komuna e Fushë Kosovës
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së